Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1046

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së (OE) "Proglobal Sh.P.K." , kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Qendra e Studenteve në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mbushje dhe furnizim i aparateve kundër zjarrit" me nr. të prokurimit: "1020890500-23-12538-2-2-1" më 20/03/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Proglobal Sh.P.K." me nr. 2023/1046 e datës, 23/12/2023, kunder vendimit, AK Qendra e Studenteve, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mbushje dhe furnizim i aparateve kunder zjarrit" me nr. të prokurimit: "1020890500-23-12538-2-2-1".

2. Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mbushje dhe furnizim i aparateve kunder zjarrit" me nr. të prokurimit: "1020890500-23-12538-2-2-1, iniciuar nga AK – Qendra e Studenteve, dhe lënda kthehet në Ri-vlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13/11/2023, Qendra e Studenteve në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Mbushje dhe furnizim i aparateve kundër zjarrit" me nr. të prokurimit: "1020890500-23-12538-2-2-1". Ndërsa me datën 07/12/2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "L & G Sh.P,K"

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 20,000.00 €.

Me 11.12.2023 OE "Proglobal Sh.P.K." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 14.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 23.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Proglobal Sh.P.K." me nr. 1046/23 për lidhur me aktivitetin "Mbushje dhe furnizim i aparateve kundër zjarrit" me nr. të prokurimit: "1020890500-23-12538-2-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Proglobal Sh.P.K." janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I):Ankuesi pretendon: " Sipas procesverbalit te ofertave, OE te cilin AK e ka rekomanduar për dhënie te kontratës "L&G" Sh.P.K ka ofertuar me çmim ne vlere totale prej 1,574.00 euro. Ne njoftimin mbi vendimin e AK te datës 07/12/2023, AK ka rekomanduar për dhënie te kontratës te njëjtin OE dhe ka ngritur çmimin ne vlerën nga vlera 1,574.00 euro ne vlerën ne 8,044.00 euro. Ngjashëm është vepruar edhe me Operatorin Ekonomik "Albkos Safety" Sh.P.K. ku sip. procesverbalit te ofertave, i njëjti ka ofertuar me çmim prej 2,960.62 euro, ndërsa ne njoftim mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit, te njëjtit OE, AK i ka shumëfishuar vlerën dhe atë ne vlerën prej 15,993.72 euro. - Prove 1, 2, 3: paramasa e OE-ve dhe formulari C, ndryshimet ne çmime. Me këto veprime, AK Qendra e Studenteve, ka shkelur dispozitat e LPP-se si tërësi dhe ne veçanti nenin 59.4 te LPP-se ku janë pranuar ndryshimet materiale dhe është rritur vlera e ofertuar. Sipas dosjes se tenderit, AK – Qendra e Studenteve, ka krijuar paramasë dhe parallogari ku ofertuesit e interesuar kane pasur te evidentuara njësitë dhe sasitë. Për te njëjtat njësi dhe sasi, te njëjtit kane ofertuar ndërsa sipas dosjes se tenderit kjo procedure e prokurimit e iniciuar nga AK, ka te beje me kontrate kornize 36 muaj ku objekti i kontratës, përkatësisht servisimin i aparateve zjarrfikës dhe duhet te behet çdo 6 muaj apo gjithësejt 6 here për tere kohëzgjatjen e kontratës. Pra, vlera e OE-ve te kontestuar dhe te përshkruar si me larte dallojnë për nga çmimi i dhënë ne ofertën financiare, dallojnë për nga çmimi i përshkruar ne formularin C – përkatësisht dallojnë sipas vlerës se përshkruar ne njoftimin mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit. - Prove 4: paramasa dhe parallogaria e ngarkuar ne e - prokurim e cila ka te përcaktuara njësit dhe sasitë. Përgjatë trajtimit te pretendimeve tona

ankimore e AK - QS, ne vendim e pohon faktin se shërbimet do te realizohen çdo 6 muaj apo 2 here ne vit, një gjë e tille është përshkruar ne paramase, operatoret ekonomik kane ofertuar çmim për shërbime çdo 6 muaj, dhe rritja e vlerës paraqet shkelje ligjore, paraqet ndryshim material nga oferta dhe keqpërdorim ne prokurim publik, përfshirë edhe keqpërdorimin e financave publike ku kjo gjë është e sanksionuar. Neni 27 i LPP-se lidhur me nenit 17 te Rregullores nr. 001/2022 shume qarte përcakton strukturën e ofertës dhe te dosjes se tenderit, përkundër këtij fakti AK - QS, ka refuzuarkërkesën tone si te pa bazuar, rrjedhimisht edhe përgjatë trajtimit te pretendimeve tona ankimore e pohon faktin se shërbimet do te realizohen çdo 6 muaj apo 2 here ne vit (6 here per 36 muaj) përkatësisht neni 17 paragrafi 7 dhe 8, përcaktojnë: 17.7 Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare. Pjesa C përbëhet nga: - Formulari i tenderit - Lista e çmimeve 17.8 Për të gjitha procedurat e përgatitura përmes platformës elektronike, AK duhet të përdorin vetëm Listën e çmimeve standarde e cila krijohet nga sistemi ose jo-standarde në formatin Excel e cila krijohet nga vetë përdoruesi. Në sistem të prokurimit elektronik dosja e tenderit dhe lista e çmimeve publikohen si dokumente të ndara. AK - QS, për këtë procedure te prokurimit ka krijuar listën e çmimeve, ka përcaktuar sasitë dhe njësitë ku ofertuesit e njëjtë janë pajtuar me kushtet dhe kane ofertuar. Prandaj AK – QS, ne asnjë rrethane nuk është dashur te rrite çmimin e ofertuar – siç edhe ka bere, dhe te krijoje çmime te reja për ofertuesit. Përkatësisht me propozimin për dhënie te kontratës me oferte te tille, pra me ndryshime dhe rritje te çmimeve, AK – QS ka konsumuar elemente te veprës penale, përkatësisht lidhja e kontratës eventuale me çmime te rritura përmbushë te gjitha elementet e veprës penale – shkaktim i demit, keqpërdorimi i parasë publike. "

Pretendimi i dytë (II): "AK – QS, sipas vendimit kundrejt kërkesës për Ri-shqyrtim potencon se ka kërkuar sqarim lidhur me çmimet te cilat janë si çmime jo - normalisht te ulëta. AK, përgjatë kërkesës për sqarim ka kërkuar dhe ka pranuar ndryshim ne çmim, ku me nenin 59 te LPP-se ndryshimet materiale janë te ndaluara. Bazuar ne ofertat financiare te përshkruara ne paramasë dhe parallogari si dhe ne formularinC, rezulton qe OE-te e sipërcituar kane dorëzuar oferta me çmime jo normalisht te ulëta dhe AK nuk i ka ndërmarr veprimet ligjore siç përcaktohet me nenin 61 te LPP-se lidhur me nenin 41 te Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Neni 41 i Rregullores për Prokurim Publik, paragrafi 3 përcakton: 41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme : i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Te gjitha përcaktimet ligjore te sipër përshkruara janë te konsumueshme dhe te cilat i kualifikojnë ofertat e "L&G" dhe "Albkos Safety" Sh.P.K. si oferta me çmim jonormalisht te ulet, ku AK nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprimi ligjor ndaj këtyre ofertave. Për me tepër, sipas nenit 3 te Dosjes se Tenderit, përkatësisht, paragrafi 1, AK ka përcaktuar qe "çmimet e njësive do te jene fikse dhe nuk do t'i nënshtrohen ndryshimeve për porosite e vendosura ne këtë kontrate publike kornize." (shiko nenin 3 nga par. 1 deri par. 3 te Dosjes se Tenderit). Gjate kërkimit te sqarimeve dhe ofrimit te tyre AK – QS ka shkelur edhe nenin 17 nga paragrafi 7 deri 12 te rregullores nr 001/20222, ku përcaktohet: 17.7 Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare. Pjesa C përbëhet nga: - Formulari i tenderit - Lista e çmimeveNe anën tjetër Udhëzuesi nr. 001/2022 për prokurim publik neni 10 përcakton qarte qe: Problemi Si te veprohet Neni LPP-se Mungon çmimi Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm Kusht administrativ Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm Kusht administrativ Lista e çmimeve nuk është plotësuar Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm Kusht administrativ Pra baza

ligjore e sipër përmendur tregon qe OE-te e larte përmendur përfshirë edhe atë te cilin AK – QS e ka rekomanduar për dhënie te kontratës dhe me te cilin insistohet te lidhet kontrate e kundërligjshme kane dorëzuar oferta te papërgjegjshme."

Pretendimi i tretë (III) : "AK, përkatësisht Zyra e Prokurimit te Qendrës se Studenteve, përveç qe ka shkelur dispozitat e LPP-se, ka shkelur edhe Ligjin nr. 04/L-012 për Mbrojtjen nga Zjarri, ka shkelur edhe udhëzimin administrativ nr. 17/2017 për testimin dhe servisimin e aparateve për fikje te zjarrit, ku përcaktohet se "Kontrollen, Servisimin dhe Mbushjen e Aparateve duhet doemos qe aparatet e tilla te servisohen, mirëmbahen dhe mbushen te paktën dy here ne vit apo 6 here për 36 muaj sa është kontrata e kësaj kontrate. Tek paramasa dhe parallogaria – oferta financiare, pozicionet 1 deri ne 3, OE i propozuar për kontrate L&G Sh.P.K ne pozicionin nr. 1 ka ofruar çmim pa TVSH ne vlere prej 3.84 euro për mbushje te AKZ, vlere kjo kur pjesëtohet me vlerën 6 del qe i njëjti OE për një mbushje ka ofruar çmimin prej 0.46 euro, përderisa P6 duhet te mbushet me 6KG pluhur. Çmimi i pluhurit me kosto te transportit, kosto te zhdoganimit dhe taksat tjera te cilat duhet te realizohet mbushja, çmimi sillet rreth 1.30 euro për KG, e qe ne rastin konkret rezulton qe i njëjti OE se bashku me OE te ranguar i dyti për nga çmimi, kane ofertuar me çmim jo normalisht te ulet. AK për vlerësim dhe ekzaminim real te ofertave, është dashur t'i referohet Udhëzuesit te publikuar me datën 04/12/2023 për analize te tregut te publikuar ne ueb faqen e KRPP-se. Prove 5 - Fatura për koston e Produktin te kontestuar Institucionet ligjzbatues për prokurim publik lidhur me çështjen identike tanimë kane nxjerre me dhjetëra vendime dhe opinione ku ndryshimet nga çmimet e ofertuara konsiderohen si shkelje te renda dhe te njëjtat janë te pandryshueshme."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Proglobal Sh.P.K." konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 24, 52, 59, 61 të LPP-së, Rregullorja për Prokurim Publik, 001/2022 Neni 17, 41, 97. Udhëzuesi për Prokurim Publik nr. 001/23 Neni 10 ,Ligji Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri ,Udhëzimi UA Nr. 17-2017 për Testimin dhe Servisimin e Aparateve kundër zjarritneni. Operatori Ekonomik Ankues "Proglobal" Sh.P.K. bazuar ne provat dhe faktet e prezantuara si me sipër, propozon ekspertin shqyrtues qe ne kuptim te nenit 113 te LPP-se, ti trajtoj pretendimet tona ankimore ne mënyrë reale dhe ne mënyrë te drejte përkatësisht paneli. Shqyrtues te nxjerrë ketë: Vendim qe te Aprovohet ne tërësi kërkesa jone si e bazuar dhe Te Anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-se – propozimi për dhënie te kontratës si i kundërligjshëm dhe lënda te kthehet ne ri-vlerësim dhe te behet vlerësim – ekzaminim real i ofertave bazuar ne dispozitat ligjore.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim.

Pretendimi nr. 1: OE i rekomanduar për kontrate i ka plotësuar te gjitha kriteret e kërkuara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit si dhe ne specifikacion teknik. Çmimi i ofertuar sipas specifikacionit te publikuar nga Autoriteti Kontraktues, eshte per nje mbushje/servisim dhe furnizim, andaj ofertat e dy operatoreve ekonomik me çmim me te ulet se oferta e operatorit ekonomik ankues janë ne rregull. Sepse, këto shërbime do te kryhen sipas rregullave te përcaktuara, apo 6 here brenda 36 muajve (2 here ne vit), ndërsa pozicioni i fundit ne paramase qe janë furnizimet do te kryhet vetëm njëherë. Ky pretendim nuk qëndron. 2. Pretendimi nr. 2: OE i rekomanduar për kontrate ka kthyer përgjigje rreth çmimit jo normalisht te ulet me ane te letrës standarde ku ka deklaruar dhe arsyetuar se qëndron prapa ofertës financiare. 3. Pretendimi nr. 3: Ju njoftojmë se Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ka ofertuar për një servisim/mbushje sipas specifikacionit, ndërsa oferta juaj duke u bazuar ne çmimin për njësi duke pas parasysh qe sasia nuk ndryshon do te jete e pamundur te llogaritet vlera për një mbushje / servisim, ose po te merrej kjo vlere e ofertuar nga ju çdo mbushje/servisim do te duhej te paguhej me kete vlere pasi qe çmimi per njesi dhe sasia nuk ndryshon. Ndersa, rreth letres standarde te pranuar sipas

Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, pjesa tek sigurimi i tenderit, ka qene gabim teknik gjate pergatitjes se këtij vendimi. Ju keni qene OE i pergjegjshem mirepo me çmim te larte. Andaj, keto pretendime dhe te gjitha pretendimet tjera qe keni shenuar ne kerkesen per rishqyrtim nuk kane asnje baze dhe kerkesa per rishqyrtim refuzohet plotesishte e pa bazuar.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 28.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1046/23, ndërsa me datë 05.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1046 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK Nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues Ndërsa OE Pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1046, të pretendimeve ankimore të OE "Proglobal Sh.P.K." ankues, si në vijim;

Konstatimi i parë (I): "Pretendimet kryesore sipas ankesës 1046/23 jane se per të dy OE-të tjerë duke përfshi OE të rekomandfuar për kontratë, me rastin e vlerësimit AK ka vendos cmime trefish më larta se ato të oftruara nga OE-të. Pas analizimit të ofertave të OE-ve pjesëmarrës, procesverbalit të hjapjes së ofertave, e në veqanti pas analizimit të formularit të dorëzimit të ofertës dhe paramasave të OE-ve pjesëmarrës sqarojmë se si OE I rekomanduar për kontratë ashtu edhe OE I dytë për nga cmim kanë ofruar cmime rreth 300% më të ulëta se cmimet të cilat AK I lexon me rastin e njoftimit mbi vendimin e AK. Po ashtu në njfotimin mbi venmdimin e AK-së , AK i drejtohet me pohimin se : "Juve ju është është dhënë kontrata me cmimin e saktësuar të tenderin tuaj 8.044.00 euro" Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar, ne nuk kemi gjetur asnjë dëshmi se OE ka "saktësuar" cmimin 8,044.00 €. OE ankues si në formular të dorëzimi ashtu edhe në procesverbal të hapjes ka cmimin total 1,574 euro. Në rast se OE ka pas gabime aritmetikore, atëher korrigjimet nuk lejohen për më shumë se 2% e cmimit total të ofruar. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore të OE ankues janë të bazuara."

Pretendimi i dytë (II) : "OE ankues po ashtu pretendon se : Bazuar ne ofertat financiare te përshkruara ne paramasë dhe parallogari si dhe ne formularin C, rezulton qe OE-te e sipërcituar kane dorëzuar oferta me çmime jo normalisht te ulëta dhe AK nuk i ka ndërmarr veprimet ligjore siç përcaktohet me nenin 61 te LPP-se lidhur me nenin 41 te Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Neni 41 i Rregullores për Prokurim Publik, paragrafi 3 përcakton: 41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme : i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Pas analizimit të njoftimit mbi vendimin e AK-së, dhe faktit se asnjë nga tre OE-të nuk jan ë eliminuar nga AK por janë shpall të pasuskesëshsëm, atëher vlerësojmë se edhe ky pretendim ankimorë është i bazuar, dhe se plotësohet të tri kushtet/rrethanat e parashijkuar me pikat (i), (ii) dhe (iii) të nenit 41.3 të Neni 41 i Rregullores për Prokurim Publik."

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Proglobal Sh.P.K.". Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertes. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Proglobal Sh.P.K." janë të bazuara.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë vlerësuar si të bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e "Mbushje dhe furnizim i aparateve kunder zjarrit" me nr. të prokurimit: "1020890500-23-12538-2-2-1". Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti ekspertit shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe

objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Proglobal Sh.P.K.” dhe se, argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Proglobal Sh.P.K.” janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mbushje dhe furnizim i aparateve kunder zjarrit” me nr. të prokurimit: “1020890500-23-12538-2-2-1”. të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës , ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me “Mbushje dhe furnizim i aparateve kunder zjarrit” me nr. të prokurimit: “1020890500-23-12538-2-2-1”., të rivlerësohet AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LLP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin, faktet e lartë përmendura, ankesën e operatorit ekonomik ankues, dokumentacionit të lëndës, dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, pas analizimi te tyre e vlerëson ankesën e operatorit si të bazuar dhe Paneli vendos të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull “Mbushje dhe furnizim i aparateve kunder zjarrit” me nr. të prokurimit: “1020890500-23-12538-2-2-1”, dhe lënda kthehet në Rivlerësim. Autoriteti kontraktues, të veproj për evitimin e gjitha shkeljeve ligjore, përkatësisht të pretendimeve ankimore të OE“Proglobal Sh.P.K.” të vlerësuara si të bazuara sipas Raportit të ekspertit shqyrtues, konstatime të cilat janë të mbështetura nga Paneli shqyrtues, me dispozitat ligjore të LPP-së. Autoriteti kontraktues obligohet që në procesin e Ri-vlerësimit t’i eliminojnë të gjitha këto shkelje ligjore të konstatuara dhe Ri-vlerësimin duhet ta bëjë gjithnjë duke u bazuar në kërkesat e përcaktuara në Dosjes tenderit dhe në LPP respektivisht nenin 59.4 i cili përcakton se Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e Autoritetit kontraktues, dhe rekomandimi me vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në Ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP-së dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, duke cituar: “Të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një

shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **QENDRA E STUDENTEVE**
- OE - **PROGLOBAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: